



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc.Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/522
Datë: 08/05/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1.10 dhe neneve 22, 53,55, si dhe 57 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet funksionalizimi i Fakultetit të Shkencave Sociale në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Obligohet menaxhmenti i Universitetit të Gjakovës që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për krijimin e infrastrukturës së mjaftueshme dhe numrit të duhur të personelit akademik që mundëson plotësimin e kërkesave akademike për një periudhë afatgjatë në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara nga AKA.
- III. Autorizohet Rektori i Universitetit të Gjakovës që në përputhje me dispozitat Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutin e Universitetit të emëroj organet e përkohshme të Fakultetit të Shkencave Sociale deri në mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta në këtë njësi akademike me fillimin e viti akademik 2020-2021.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2020 pasi diskutimit lidhur me propozimin për funksionalizim të Fakultetit të Shkencave Sociale, bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues të vitit 2013 për themelin e Fakultetit të Shkencave Sociale, dhe duke pasur parasysh se UGJFA është në proces të akreditimit të programit studimor Kujdesi dhe Mirëqenia Sociale, njësi e Fakultetit të Shkencave Sociale, përgatitjes së infrastrukturës fizike dhe sigurimit të një numri të mjaftueshëm të personeli akademik, e konsideroj si të arsyeshëm propozimin, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Menaxhmentit të UGJFA-së;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova